



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"



Kapitulli 2

PJESËMARRËSIT KRYESOR NË VEPRIMET E TREGJEVE FINANCIARE

Ph.D. Fisnik Morina





TREGJET DHE INSTITUCIONET FINANCIARE



2

- Lënda: Tregjet dhe Institucionet Financiare
- Viti II-të, Semestri IV, Departamenti: Administrim Biznesi
- Statusi i lëndes: Obligative
- Javët mësimore: 15 (2 orë ligjerata, 2 orë ushtrime)
- Ph.D. Fisnik Morina
- Emaili: fisnik.morina@unhz.eu





PJESËMARRËSIT KRYESORË NË VEPRIMET E TREGJEVE FINANCIARE



3

- Në veprimet e tregjeve financiare, përveç individëve të veçantë marrin pjesë dhe dy kategori kryesore të institucioneve financiare, që janë **Banka Qendrore** e çdo vendi dhe **institucionet financiare** të specializuara në fusha të ndryshme të ekonomisë. Secili nga këto institucione ka objektin e tij të veçantë të veprimtarisë dhe themelohet e funksionon sipas rregullave të mirëpërcaktuara.
- Duke marrë parasysh rëndësinë dhe rolin e institucioneve bankare dhe financiare në çdo vend ekziston një numër i madh aktesh dhe nënaktesh ligjore që disiplinojnë veprimtarinë e të gjitha llojeve të tyre.



DREJTIMET KRYESORE TË KONTROLLIT DHE TË MBIKËQYRJES SË INSTITUCIONEVE BANKARE DHE FINANCIARE



4

- Veprimtaria e institucioneve bankare dhe financiare ka një rëndësi thelbësore si për ekonominë e çdo vendi, ashtu dhe për interesat e individëve të veçantë dhe të shtetit në tërësi.
- S'ka dyshim se në secilin vend aktet dhe nënaktet e shumta ligjore që disiplinojnë veprimtarinë e institucioneve bankare dhe financiare kanë veçori të shumta, por në të gjitha rastet ato synojnë në sigurimin e kontrollit dhe të mbikëqyrjes së veprimtarisë të këtyre institucioneve në këto drejtime kryesore:
- *Së pari*, në drejtim të sigurimit të garancisë dhe të qëndrueshmërisë të veprimtarisë të çdo institucioni për mbrojtjen më të mirë të interesave të klientëve të tyre.
- *Së dyti*, Banka Qendrore e çdo vendi nepërmjet zbatimit të politikës së saj monetare ushtron një kontroll të vazhdueshëm mbi institucionet e ndryshme bankare dhe financiare nepërmjet vendosjes së depozitave të detyrueshme që këto institucione duhet të mbajnë pranë bankës qendrore dhe nepërmjet përcaktimit të madhësisë së likuiditeteve që ato duhet të mbajnë në dispozicion.



- ***Së treti***, nepërmjet veprimtarisë dhe vendimeve të saj Banka Qendrore e çdo vendi përcakton jo vetëm madhësinë totale të kreditimit të ekonomisë, por mund të përcaktojë dhe madhësinë minimale të kredive që çdo bankë detyrohet të investojë në degën përkatëse të ekonomisë, duke luftuar kështu çdo tendencë diskriminuese në fushën e kreditimeve.
- ***Së katërti***, në aktet dhe nënaktet ligjore parashikohet mbrojtja e investitorëve të ndryshëm që blejnë nepërmjet institucioneve bankare dhe financiare letra të ndryshme me vlerë.



- ***Së pesti***, aktet dhe nënaktet ligjore përcaktojnë me hollësi dhe saktësinë më të madhe kushtet e themelimit dhe të zhvillimit të veprimtarisë së çdo institucioni bankar e financiar, llojet e ndryshme të veprimtarisë së tyre, llojet e produkteve financiare me të cilat ato do të kryejnë veprimet në tregjet përkatëse si dhe shtrirjen gjeografike të veprimtarisë së tyre.
- ***Së gjashti***, aktet dhe nënaktet përkatëse ligjore parashikojnë për çdo lloj të institucioneve bankare të gjitha rregullat e hartimit dhe të vlerësimit si të zërave të ndryshme të aktivitetit dhe të pasivitetit të bilancit të tyre kontabël ashtu dhe të zërave që paraqiten jashtë bilancit të tyre kontabël.



- Nga respektimi i këtyre rregullave varet pasqyrimi i drejtë i gjendjes dhe i rezultateve të veprimtarisë së çdo institucioni bankar ose financiar dhe për pasojë informimi i saktë i publikut dhe i organeve tatimore mbi problemet që karakterizojnë çdo institucion.
- Në aktet dhe nënaktet ligjore të çdo vendi parashikohen dhe rregullat e veprimtarisë së bankave të vendit që kanë filialet e tyre jashtë shtetit, si dhe rregullat e veprimtarisë së bankave të huaja të vendosura në vendin e vet.
- Për sa u përket institucioneve të ngarkuara me kontrollin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së institucioneve bankare dhe financiare, ato ndryshojnë jo vetëm nga një vend në tjetër, por edhe nga një lloj institucionesh në një tjetër.
- Kështu në SHBA organe më të larta të mbikëqyrjes dhe të kontrollit të veprimtarisë së institucioneve bankare dhe financiare janë *Sistemi Federal i Rezervave*, që luan rolin e Bankës Qendrore të SHBA dhe *Komisioni i letrave me blerë dhe i bursave*, kurse në Republikën e Shqipërisë si organe të tilla shërbejnë *Banka e Shqipërisë me Këshillin e saj Mbikëqyrës* dhe *Komisioni i Letrave me Vlerë*.



BANKA QENDRORE DHE ROLI I SAJ NË TREGJET FINANCIARE



8

- Një nga pjesëmarrësit më të rëndësishëm në veprimet e tregjeve financiare të çdo vendi është *Banka Qendrore* e tij. Veprimtaria dhe instrumentet financiare që përdor çdo Bankë Qendrore luajnë një rol shumë të rëndësishëm në ecurinë e përgjithshme të ekonomisë së çdo vendi dhe veçanërisht në veprimet e tregjeve financiare në rang kombëtar dhe ndërkombëtar.
- **Sistemi bankar i çdo vendi përbëhet nga dy nivele ose hallka kryesore**
- Banka Qendrore
- Banka e Bankave dhe nga bankat e ndryshme tregtare
- Në të gjitha vendet Bankat Qendrore kanë pak a shumë të njëjtat detyra dhe kryejnë pak a shumë të njëjtat funksione. Në mënyrë më të plotë dhe komplekse detyrat dhe funksionet e një Banke Qendrore mund të sqarohen duke marrë si shembull Bankën Qendrore të SHBA, veprimtaria e së cilës ndikon jo vetëm në ekonominë e SHBA, por edhe në tregjet financiare të të gjithë botës. Në SHBA rolin e Bankës Qendrore e luan “*Sistemi Federal i Rezervave*” i themeluar që në vitin 1913.

- ❑ **Sistemi Federal i Rezervave përbëhet nga tre organizma kryesore që janë :**
- ❑ ***Bordi i Guvernatorëve që quhet edhe Bordi i Rezervave Federale.***
- ❑ ***Bankat Federale.***

Këto banka federale shërbejnë edhe si institucione depozitimi për bankat e reja të rajonit të tyre. Federale të rajoneve të ndryshme të SHBA janë :

- ❑ Banka Federale e New York-ut
- ❑ Banka Federale e Chicago-s
- ❑ Banka Federale e San Franciscos
- ❑ Banka Federale e Cleveland-it
- ❑ Banka Federale e Philadelphia-s
- ❑ Banka Federale e Richmond-it
- ❑ Banka Federale e Atlante-s
- ❑ Banka Federale e St.Louis-it
- ❑ Banka Federale e Kansas City-t
- ❑ Banka Federale e Boston-it

- Banka Federale e Dallas-it
- Banka Federale e Minneapolis-it

Më të rëndësishme nga pikëpamja e vëllimit të punës (rreth 50%) dhe e rolit që kryejnë në ekonominë e SHBA konsiderohen tri bankat federale d.m.th Banka Federale e New York-ut, e Chicago-s dhe e San Franciscos.

□ *Komiteti Federal i Veprimeve të Tregut të Hapur*

Është organizmi më i rëndësishëm për zbatimin e politikës monetare të Sistemit Federal Të Rezervave. Gjithë sistemi Federal i Rezervave i SHBA i përbërë nga tre organizmat e përmendura funksionon si një mekanizëm unik e kompleks për realizimin e detyrave të BQ:

- I. Formulimin dhe zbatimin e politikës monetare
- II. Mbikëqyrjen e veprimtarisë së bankave tregtare
- III. Emetimin e monedhave të reja dhe tërheqja nga qarkullimi i monedhave të dëmtuara
- IV. Kreditimin e bankave tregtare dhe përcaktimin e madhësisë së kreditimit të ekonomisë
- V. Kryerjen e funksioneve të arkës të buxhetit të shtetit
- VI. Përpunimin e modelit të tregtisë së jashtme
- VII. Kryerjen e xhirimeve të fondeve nga një bankë në tjetër
- VIII. Kryerjen e studimeve ekonomiko-financiare dhe dhënien e këshillave për problemet ekonomiko-financiare presidentit të vendit.

- Politika monetare e formular nga Këshilli Federal i Guvernatorëve realizohet në praktikë nepërmjet përdorimit të instrumenteve të ndryshme të politikës monetare më të rëndësishme nga të cilat janë:
 - *Veprimet e tregut të hapur*
 - *Përcaktimi dhe ndryshimi i normës së skontimit të SFR*
 - *Përcaktimi dhe ndryshimi i madhësisë së rezervave monetare dhe normës së interesit të Fondeve Federale*

Të gjitha veprimet e tregtimit të obligacioneve shtetërore në tregun e hapur kryhen nga agjentët e Departamentit të Tregtimit të Bankës Federale të New York-ut nepërmjet sistemit elektronik të komunikimit që krijon lidhjet dhe xhirimet e nevojshme ndërmjet Bankave Federale dhe bankave tregtare.

Shuma e blerjeve ose e shitjeve të obligacioneve shtetërore ndikojnë direkt në ndryshimin e madhësisë së ofertës monetare të përbërë nga tre agregate kryesore (**M1**, **M2**, dhe **M3**) me pasojat përkatëse në rritjen ose në uljen e madhësisë së kreditimit dhe të normave të interesit.



Përmbajtja e agregateve të ofertës monetare M1, M2 dhe M3

□ M1

Përfshihen

1. Kartëmonedhat dhe monedhat metalike në qarkullim
2. Depozitat e klientëve në llogari rrjedhëse bankare dhe në llogari të veçanta bankare për të cilat klientët kanë të drejtë të lëshojnë çëçe
3. Çëçet turistikë në duart e individëve të ndryshëm ose në duart e njësive ekonomike jashtë sistemit të bankave dhe të kreditit

□ M2

Përveç shumës së agregatit M1, përfshihen akoma edhe

1. Depozitat në llogari bankare kursimi
2. Depozitat e vogla në llogari bankare me afat
3. Depozitat bankare në llogari të kuotshme në tregun monetar
4. Njësiti e fondeve të investimeve të kuotueshme në tregun monetar
5. Marrëveshjet afatshkurtra të riblerjes



□ M3

Përveç shumës së M2 përfshihen akoma

1. Depozitat e mëdha bankare me afat
2. Fondet e investimeve të institucioneve financiare të kuotueshme në tregun monetar
3. Marrëveshjet afatgjata të riblerjes
4. Depozitat me afat të valutave të huaja.

Banka Qendrore e çdo shteti luan dhe rolin e huadhënësit të fundit për të gjitha bankat tregtare të vendit. Për këtë arsye një nga instrumentat e politikës monetare të SFR është përcaktimi dhe ndryshimi i normës së skontimit

Norma e skontimit përfaqëson normën e interesit me të cilën Bankat Federale të Rezervave kreditojnë bankat tregtare që kërkojnë fonde federale për shtimin e rezervave të tyre monetare nëpërmjet skontimit të kambialeve përkatëse.



- Më konkretisht Sistemi Federal i Rezervave (SFR) përdor instrumentin e normës së skontimit në tre raste kryesore kur bën ofrimin e:
 - *Kredive rregulluese*
 - *Kredive sezonale*
 - *Kredive të zgjerimit*
- Rezervat monetare të bankave tregtare përbëhen nga dy pjesë:
 - *Nga rezervat e detyrueshme*
 - *Nga Rezervat përtej shumës së rezervave të detyrueshme*

Rezervat e detyrueshme përfaqësojnë shumën minimale të rezervave monetare që bankat tregtare duhet të depozitojnë pa asnjë interes pranë Bankave Federale të rajonit të tyre, dhe madhësia e tyre ndryshon ose nga ndryshimi i veprimeve të depozitimit pranë bankave tregtare, ose nga ndryshimi i normës të rezervave të detyrueshme të vendosur me ligj.



- Bankat Federale si dhe të gjitha Bankat Qendrore nuk kanë për qëllim kryesor fitimin, por realizimin e një politike monetare për një ecuri më të mirë ekonomike të vendit.
- **Të ardhurat e tyre Bankat Federale i sigurojnë nga tre burime që janë**
- Interesat e fituara nga obligacionet shtetërore gjatë trajtimit të veprimeve të tregut të hapur
- Interesat e arkëtuara nga rezervat e detyrueshme të bankave tregtare pranë bankave federale
- Komisionet arkëtuara për kryerjen e veprimeve të ndryshme të xhirit dhe të likuidimeve ndërbankare etj.

- **Burimet kryesore të Bankave Federale të pasqyruara në pasivin e bilancit kontabël sipas rëndësisë së tyre janë**
- Gjendja e monedhës jashtë sistemit bankar
- Gjendja e monedhës në arkat dhe kasafortat e bankave tregtare
- Rezervat e institucioneve të depozitimit
- Depozitat e qeverisë federale
- Depozitat e pjesës tjetër të Botës
- Detyrime të ndryshme
- **Për sa i përket vendosjes së këtyre burimeve të BQ sipas aktivitetit të bilancit karakterizohet nga llojet e mëposhtme të përdorimeve**
- Obligacione të thesarit të SHBA
- Likuiditete të thesarit
- Marrëveshjet e riblerjes së obligacioneve
- Rezervat e arit dhe të valutave të huaja
- Hua të dhëna bankave të vendit
- Aktive të ndryshme



BANKA E SHQIPËRISË



17





- Si dhe në vendet e tjera sistemi bankar i Shqipërisë përbëhet nga dy nivele që janë: Banka Qendrore e përfaqësuar nga “Banka e Shqipërisë” dhe nga bankat e tjera të nivelit të dytë të vendit, nga degët e bankave të huaja të vendosura në vend...
- Banka e Shqipërisë është themeluar dhe funksionon në bazë të dispozitave të nenit 161 të Kushtetutës së Repub. Të Shqipërisë të aprovuar nga Parlamenti më 21.10.1998.
- Objektivi kryesor i veprimtarisë së saj është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve, nepërmjet hartimit dhe zbatimit të pavarur të një politike monetare.
- Organi më i lartë i veprimtarisë dhe i mbikëqyrjes së politikave, të administrimit dhe i kryerjes së operacioneve në Bankën e Shqipërisë është Këshilli Mbikëqyrës në krye të të cilit qëndron Guvernatori që propozohet nga Presidenti i Republikës, aprovohet nga Kuvendi Popullor dhe qëndron në të njëjtin post për 7 vjet me të drejtë rizgjedhjeje.



- **Këshilli Mbikëqyrës i saj ka këto kompetenca kryesore**
- Miratimin e politikës monetare të Republikës së Shqipërisë
- Vendos mbi regjimin dhe politikën e këmbimeve valutore të Repub. Shqipërisë
- Miraton të gjitha vendimet, rregulloret dhe udhëzimet me zbatim të përgjithshëm që nxirren nga Banka e Shqipërisë
- Përcakton vlerën nominale, prerjet dhe konfigurimin e kartëmonedhave dhe të monedhave, si dhe kushtet e tërheqjes së tyre nga qarkullimi
- Miraton kreditë e Bankës së Shqipërisë për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë.
- Miraton dhe revokon dhënien e miratimeve paraprake dhe të licencave për ushtrimin e veprimtarisë bankare
- Përcakton strukturën organizative të Bankës së Shqipërisë
- Miraton emërimet e drejtuesve të departamenteve në Bankën e Shqipërisë
- Miraton raportet vjetore dhe financiare të Bankës së Shqipërisë
-

Ju Faleminderit për vëmendje !

20

□ SUKSESE !

